



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 91

Tiranë – E hënë, 30 maj 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit të Republikës nr. 9604, datë 17.5.2016	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 5207
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe i ministrit të Financave nr. 11, datë 17. 3.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin e përbashkët nr. 4, datë 16.2.2015 të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe nr. 2614/1, datë 19.3.2015 të Ministrisë së Financave, “Për kriteret dhe procedurat financiare për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit” 5207
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 13, datë 17.5.2016	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar..... 5209
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 14, datë 18.5.2016	Për procedurën, afatet dhe formatin e shtypjes dhe prodhimit të biletave të lojërave të fatit dhe mënyra e emetimit të biletës <i>online</i> , si dhe format e tjera të pranimit të pjesëmarrjes në lojën <i>online</i> 5211
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 62, datë 13.5.2016	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009, të ndryshuar 5213

**DEKRET**

Nr. 9604, datë 17.5.2016

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Kulturës dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Norë Abaz Osmani Begolli (Osmani)
2. Lekë Kushtrim Begolli
3. Kushtrim Ismet Begolli
4. Dren Ferid Abazi
5. Jon Nazim Krasniqi
6. Leutrim Selim Berisha
7. Vlona Idriz Gashi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 11, datë 17. 3.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT
NR. 4, DATË 16.2.2015 TË MINISTRISË
SË MIRËQENIES SOCIALE DHE
RINISË DHE NR. 2614/1, DATË 19.3.2015
TË MINISTRISË SË FINANCAVE,
“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT
FINANCIARE PËR ZBATIMIN E
PROGRAMEVE TË NXITJES SË
PUNËSIMIT”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit” të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, “Për progra-

min e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, “Për programin e nxitjes së punësimit të punë-kërkuesve të papunë në vështirësi, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë, që hyjnë për herë të parë në punë”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012, “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.4.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 27.1.2016, “Për programin e nxitjes së punësimit të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit” dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit miratuar me vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 17.1.1998, “Për miratimin e statutit të shërbimit kombëtar të punësimit”, i ndryshuar.

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin e përbashkët nr. 4, datë 16.2.2015 të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe nr. 2614/1, datë 19.3.2015, të Ministrisë së Financave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 5, pjesa I “Klasifikimi buxhetor”, paragrafi “Artikulli 603.1”, “Subvencion për të nxitur punësimin”, të ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në këtë artikull do të evidentohet totali i të gjitha shpenzimeve që kanë të bëjnë me “Programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar, “Programin e nxitjes së punësimit të punë-kërkuesve të papunë në vështirësi”, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, të ndryshuar “Programin e nxitjes së



punësimin të femrave nga grupet e veçanta”, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012, të ndryshuar, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimin të punëkërkuësve të papunë, që hyjnë për herë të parë në punë”, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale të punëkërkuësve të papunë që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuësit e papunë që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”, të ndryshuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.4.2014, “Për programin e nxitjes së punësimin të personave me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar, si edhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 27.1.2016, “Për programin e nxitjes së punësimin të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit”.”

2. Pika 5, pjesa I “Klasifikimi buxhetor”, paragrafi “Nënartikulli 6031100”, “Shpenzime për paga” të ndryshohet si më poshtë vijon:

“Do të përbëhet nga pagat që do t’u jepen punëkërkuësve sipas pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar, pikës 1 “b” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, sipas pikës 9 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, të ndryshuar, sipas pikës 1 “b” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012, të ndryshuar, sipas pikës 1 “b” dhe 1 “ç” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, të ndryshuar, pikës 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.4.2014, të ndryshuar, si edhe të pikës 1 “b” dhe 1 “c” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64 datë 27.1.2016, “Për programin e nxitjes së punësimin të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit”.”

3. Pika 5, pjesa I “Klasifikimi buxhetor”, paragrafi nënartikulli 6031200, “Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore” të ndryshohet si më poshtë:

“Nënartikulli 6031200 “Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore”,

Do të përbëhet nga shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, masa e së cilës përcaktohet në udhëzimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për pikën 1 “a” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, i ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27 datë 11.1.2012, i ndryshuar, të pikës 1 “b” dhe të pikës 1 “c” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, i ndryshuar, të pikës 9 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, i ndryshuar, për pikën 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar dhe pikave 1 dhe 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.4.2014, të ndryshuar, si edhe të pikës 1 “b” dhe 1 “ç” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 27.1.2016, “Për programin e nxitjes së punësimin të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit”, paguhet kontributi për sigurimin nga aksidentet në punë.

4. Pika 5, pjesa I “Klasifikimi buxhetor”, paragrafi nënartikulli 6031400 “Subvencion për të nxitur punësimin”, të ndryshohet si më poshtë:

“Nënartikulli 6031400 “Subvencion për të nxitur punësimin”

Subvencionet përbëhen nga pagesat që kryhen nga drejtoritë rajonale të punësimin sipas pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248 datë 30.4.2014, të ndryshuar, pikës 1 “a”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 27.1.2016, “Për programin e nxitjes së punësimin të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit” si edhe të pikës 1 “a”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, të ndryshuar. Ky subvencion t’i xhirohet çdo muaj subjektit, që aplikon programin e nxitjes së punësimin. Për sa i përket vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, të ndryshuar, subvencionohet vetëm punëkërkuësi.”

5. Pika 5, pjesa II “Procedurat e financimit”, të ndryshohet si më poshtë:

“Për miratimin e projekteve fituese, zyra përkatëse e punësimin do të paraqesë pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimin, dokumentacionin që përcaktohet në vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë



16.1.2008, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248 datë 30.4.2014, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 27.1.2016, “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre”.”

6. Pika 6, pjesa II “Procedurat e financimit”, të ndryshohet si më poshtë;

“Drejtoritë rajonale të punësimit do të financojnë projektet e nxitjes së punësimit (projektet e zyrave rajonale dhe zyrave vendore) sipas pikave 1 dhe 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, të ndryshuar, sipas pikës 1 “a” dhe “b”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, të ndryshuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, të ndryshuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, të ndryshuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012, të ndryshuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.4.2014, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64 datë 27.1.2016, “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit” mbas datës 10 të çdo muaji për aktivitetin e muajit të mëparshëm. Për muajin dhjetor xhirimi i fondeve do të bëhet brenda datës 31 dhjetor.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj

UDHËZIM

Nr. 13, datë 17.5.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 159, paragrafi 2, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

“Neni 41, “Përjashtimi nga TVSH-ja i shërbimeve financiare”, ndryshon me këtë përmbajtje:

1. Bazuar në nenin 53, shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja transaksionet financiare të parashikuara dhe të shprehura në mënyrë të qartë dhe shteruese në këto dispozita, pavarësisht nëse këto transaksione kryhen nga një institucion financiar, ose jo.

Çdo transaksion tjetër që nuk është i shprehur në nenin 53 të ligjit, pavarësisht nëse është furnizuar nga një bankë ose institucion financiar apo është furnizuar për një bankë ose institucion financiar, nuk përjashtohet nga TVSH-ja. Përjashtimi nga TVSH-ja zbatohet kur transaksioni i kryer është njëri nga shërbimet e parashikuara në këtë dispozitë.

Aplikimi i përjashtimit lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me natyrën e shërbimit dhe jo me entitetin ose subjektin që ofron shërbimin dhe as personin që merr shërbimin. Identiteti i palëve është i parëndësishëm. Mënyra e ofrimit të shërbimit në mënyrë elektronike, manuale apo automatike, gjithashtu, është e parëndësishme në aplikimin ose jo të përjashtimit.

Shembull 1. Një klient paraqitet pranë një banke për të marrë një kredi. Dhënia dhe negociimi i kredisë edhe menaxhimi i saj janë operacione të përjashtuara nga TVSH-ja, kur furnizohen nga kredidhënësi. Klienti paraqet një dosje jo shumë të



mirë dhe banka refuzon kredinë ose i jep një kredi jo të favorshme. Një person i tatueshëm, i cili kryen veprimtari si negociues, merr përsipër të kryejë këtë shërbim për klientin pranë bankës. Ky person mund të jetë individ ose agjenci. Shërbimi i kryer nga negociuesi për klientin nuk është shërbim i përjashtuar nga TVSH-ja, por i tatueshëm me TVSH. Shërbimi i negocimit përjashtohet nga TVSH-ja kur kryhet (furnizohet) nga kredidhënësi, që në këtë rast është banka. Edhe në rastin kur komisioni i ndërmjetësimit i faturon bankës prej personit të tatueshëm ai është i tatueshëm me TVSH.

Shembull 2. Një bankë jep me qira bankomatit për përdorim një banke tjetër. Ky operacion nuk është i përjashtuar nga TVSH-ja edhe pse kryhet nga banka, pasi nuk është në listën e furnizimeve të përjashtuara në këtë dispozitë.

Mirëmbajtja e bankomatit, gjithashtu, apo e sistemit të IT të bankës nuk janë shërbime të përjashtuara nga TVSH, për sa nuk janë shërbime financiare të listuara në nenin 53 të ligjit. Këto shërbime kryhen nga persona të tatueshëm të TVSH-së dhe u nënshtrohen rregullave të përgjithshme për aplikimin e TVSH-së sipas vendit të furnizimit.

Shembull 3. Një kompani e njohur e programeve kompjuterike prodhon një program specifik bankar sipas porosisë së një banke. Sistemi do të përdoret për sistemin e pagesave të bankës. Në këtë rast kemi të bëjmë me një furnizim shërbimi siç është shitja e *software*-it për bankën nga shoqëria e programeve kompjuterike. Ky shërbim është i tatueshëm me TVSH, për sa furnizimi i *software*-ve të çdo lloji nuk është një furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit.

Përjashtimi nga TVSH-ja në parim përcaktohet për furnizimin e shërbimit dhe jo për klientin që e përfiton shërbimin.

Janë të përjashtuara nga TVSH-ja shërbimet financiare të mëposhtme:

- Dhënia, negocimi, menaxhimi i kredive nga ana e vetë kredidhënësit.

Shembull. Vlerësimi i pasurisë si garanci për kredinë, i kryer nga një vlerësues pasurie është shërbim i tatueshëm me TVSH.

- Negocimi ose marrëveshje të ngjashme për garantimin e kredive, ose çdo garanci që ka lidhje me paratë, ose menaxhimi i garancive të kredive, kur kryhen nga kredidhënësi;

Shembull. Me qëllim menaxhimin e garancisë së kredisë, një bankë i kërkon informacion institucioneve që merren me regjistrimin e pronave për të verifikuar disa prona të luajtshme ose të paluajtshme nëse kanë ose jo barrë hipotekore ose barrë siguroese, për disa klientë që kanë aplikuar për kredi në bankë. E njëjta gjë kur banka u kërkon të vendosin barrë mbi pronën për kredinë. Këto institucione, persona të tatueshëm, i furnizojnë bankës një shërbim për verifikimin dhe informacionin e dhënë të kërkuar nga banka ose për shërbimin e vendosjes së barrës apo hipotekës. Këto shërbime nuk janë shërbime financiare në kuptim të nenit 53 të ligjit, pavarësisht nëse kryhen për një institucion financiar, Banka nga ana e saj kur i faturon shërbimin klientit në përfundim të negocimit për kredinë (përfshin në shërbimin për klientin gjithë vlerën e shërbimeve që lidhen me kredinë) ia faturon si shërbim të përjashtuar nga TVSH-ja sipas nenit 53, pika “c”, të ligjit.

- Transaksionet përfshirë negocimin lidhur me veprimet e këmbimit, depozitat, llogaritë rrjedhëse, furnizimin e likuiditeteve nëpërmjet pagesave, transfertave, huadhënia, çeqet dhe instrumentet e tjera të negociueshme;

- Transaksionet përfshirë negocimin lidhur me valutën, kartëmonedhat apo monedhat e përdorura si mjete ligjore pagese;

- Transaksionet përfshirë negocimin në aksione, kuota, pjesë në shoqëri apo shoqata, në obligacione e tituj të tjerë, përveç titujve për mallrat dhe të drejtat ose titujt mbi pasurinë e paluajtshme që përcaktohen në nenin 8, të ligjit;

Shembull. Shoqëria “Invest” merr përsipër sipas një kontrate shërbimi ti sigurojë dhe ofrojë klientit të saj i cili menaxhon një fond investimi të dhënat e kërkuara në lidhje me fondin e investimit. Gjithashtu, ajo proceson, verifikon formularët e investitorëve potencialë, duke siguruar që ato të jenë përpiluar, deklaruar dhe paguar korrekt. Këto shërbime shoqëria i kryen kundrejt pagesës. A duhet të konsiderohet shërbimi i ofruar nga shoqëria “Invest” si një transaksion i lidhur me transferimin ose negocimin e titujve/letrave me vlerë? Këto shërbime janë shërbime me natyrë administrative mbështetëse dhe si të tilla, shërbimet administrative mbështetëse që nuk shkaktojnë një ndryshim të pozicionit financiar dhe ligjor të palëve, nuk janë shërbime të përjashtuara.



Gjithashtu, shërbimet për “menaxhimin dhe ruajtjen e titujve” përjashtohen shprehimisht nga aplikimi i përjashtimit të TVSH-së sipas pikës “dh” të nenit 53 të ligjit.

- Përjashtohet, gjithashtu, bazuar në nenin 152 të ligjit furnizimi dhe importimi i arit për investim.

2. Bazuar në nenin 53 të ligjit, përjashtimi nga TVSH-ja nuk aplikohet për transaksionet e mëposhtme:

- Shërbimi i mbledhjes së borxhit

Shembull. Një bankë ka dhënë kredi e cila nuk është shlyer. Banka kryen veprime për mbledhjen e borxhit të saj duke bllokuar në llogarinë e klientit shumën e kredisë së pashlyer dhe një komision shtesë (e ngjashme me veprimtarinë përmbartuese). Komisioni që banka përfiton nga llogaria e klientit në këtë rast është pagesë për mbledhjen e borxhit e cila është e tatueshme me TVSH.

- Transaksionet përfshirë negocimin për monedhat dhe kartëmonedhat për koleksion, që do të thotë monedha ari, argjendi apo monedha të tjera metali ose kartëmonedha që nuk përdoren normalisht si mjet ligjor pagese ose monedha që paraqesin interes numizmatik;

- Transaksionet për menaxhimin apo ruajtjen e aksioneve, kuotave, pjesë në shoqëri apo shoqata, në obligacione dhe tituj të tjerë, si dhe titujt mbi mallrat dhe të drejtat apo titujt mbi pasurinë e paluajtshme që përcaktohen në nenin 8 të ligjit;

- Qiradhënia e kasafortave edhe nëse ky shërbim kryhet nga një bankë është i tatueshëm për TVSH-në.

Shërbimet e renditura në këtë pikë nuk janë shteruese. Çdo shërbim tjetër, i cili nuk bën pjesë në shërbimet e përjashtuara të përcaktuara në nenin 53 të ligjit, të renditura në pikën 2 të këtij neni, janë furnizime shërbimi të tatueshëm me TVSH.

3. Bazuar në pikën “e”, të nenit 53 të ligjit përjashtohet nga TVSH-ja, menaxhimi i fondeve të investimeve, në kuptim të ligjit për sipërmarrjet e investimeve kolektive.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj

UDHËZIM

Nr. 14, datë 18.5.2016

PËR PROCEDURËN, AFATET DHE FORMATIN E SHTYPJES DHE PRODHIMIT TË BILETAVE TË LOJËRAVE TË FATIT DHE MËNYRA E EMETIMIT TË BILETËS *ONLINE*, SI DHE FORMAT E TJERA TË PRANIMIT TË PJESËMARRJES NË LOJËN *ONLINE*

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 13, pika 2 dhe nenit 70, pika 4, e ligjit nr. 155/2015, datë 21.12.2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave,

UDHËZON:

1. Shtypja e biletave të lojërave të fatit kryhet në përputhje me ligjin nr. 155/2015, datë 21.12.2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Lojërave të Fatit, miraton çdo biletë të re që hidhet në qarkullim nga organizatori i lojërave të fatit. Për këtë qëllim, organizatori paraqet pranë AMLF-së dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën për miratim të biletës, shoqëruar me modelin e biletës së propozuar nga organizatori;

b) Kontratën e lidhur me prodhuesin e biletës (përveç rasteve kur modeli i biletës parashikon printim në printerë termikë);

c) Detaje teknike të lojës dhe biletës.

3. Bileta e propozuar nga organizatori duhet të përmbajë elementet si më poshtë:

a) Emrin e organizatorit të lojës;

b) Të përmbajë nënshkrimin e “Miratuar nga drejtori i Përgjithshëm i Lojërave të Fatit”;

c) Çmimin e biletës në lekë (përjashtuar biletat ku çmimi përcaktohet sipas rastit);

d) Numri serial i biletës (numër progresiv i veçantë për secilin operator);

e) Bileta *online* do të marrë një numër serial unik nga Sistemi Qendror i Monitorimit *online*;

f) Elementi i sigurisë së biletës (për biletat e lotarisë së çastit);

g) Rregullorja e lojës me çmimet përkatëse për fituesin (për biletat e lotarisë së çastit);



h) Llojin/modelin e printerëve që do të printojnë biletat e lojës dhe detajet teknike të tyre.

4. Biletat e lojërave të fatit shtypen në shtypshkronjën e letrave me vlerë. Kur shtypshkronja e letrave me vlerë nuk ka kapacitet teknologjik për shtypjen e biletave, ato mund të shtypen në shtypshkronja brenda ose jashtë vendit.

4.1 Operatorët e miratuar për zhvillim aktiviteti lojërash fati, i dërgojnë paraprakisht shtypshkronjës së letrave me vlerë (SHLV-së) kërkesë për shtypjen e biletave të lojës së fatit, e cila do t'i propozohet për miratim ministrit të Financave. Me marrjen e kërkesës për shtypjen e biletave të lojërave të fatit nga operatori, shtypshkronja e letrave me vlerë vlerëson, nëse:

a) Ka apo jo kapacitetin teknik për shtypjen e kësaj bilete në formën dhe specifikimet e kërkuara nga operatori;

b) Negocim me operatorin, duke i propozuar këtij të fundit ndryshimet e nevojshme, me qëllim bërjen të mundur të shtypjes së biletës pranë këtij institucioni, sipas mundësive të këtij të fundit;

c) Nëse edhe pas negociimit operatori nuk bie dakord për ndryshimet e propozuara dhe SHLV-ja vlerëson se nuk ka kapacitetin e duhur teknologjik të shtypjes së biletave të kërkuara, mblidhet bordi drejtues i SHLV-së, i cili shqyrton dhe analizon kapacitetet teknike. Nëse bordi drejtues konstaton, gjithashtu, që SHLV-ja nuk ka kapacitetet teknike për shtypjen e këtyre biletave dhe argumenton pamundësinë e kthimit ekonomik nëse do të investohej për blerjen e teknologjisë së munguar për këto raste, shprehet me vendim;

ç) Vendimi i Bordit drejtues për pamundësinë e ofrimit të shërbimit, i komunikohet operatorit kërkuar dhe Autoritetit Mbikëqyrës të Lojërave të Fatit, i shoqëruar ky me dokumentacionin justifikues që ka çuar në marrjen e këtij vendimi. Në vijim, operatori mund të procedojë me nënshkrimin e kontratës për shtypjen e këtyre biletave në shtypshkronja brenda ose jashtë vendit dhe vë në dijeni institucionin mbikëqyrës së aktivitetit të tij (AMLF-në);

d) AMLF-ja, pasi merr dijeni për vendimin e SHLV-së, kërkesën e operatorit dhe dokumentacionin e parashikuar në pikat 2 dhe 3 të këtij udhëzimi, së bashku me opinionin e tij të

mirargumentuar, i dërgon për miratim ministrit të Financave biletën e propozuar nga operatori me të njëjtat specifikime, detaje teknike dhe format, si ato të dërguara nga vetë operatori për SHLV-në.

4.2 Në zbatim të pikës 4.1, Autoriteti Mbikëqyrës i Lojërave të Fatit merr në disponim nga operatori dhe shtypshkronja e letrave me vlerë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të garantuar shmangien e abuzimeve të mundshme.

5. Në kontratën e lidhur me shtypshkronjën e letrave me vlerë apo me shtypshkronja brenda ose jashtë vendit, do të përcaktohet data e fillimit të shtypjes së biletave, data e dorëzimit të biletave, sasia në copë e biletave, numri serial i biletave, çmimi i shtypjes së biletave, specifikimet teknike të biletave dhe vendosja e elementeve të sigurisë në biletë.

6. Organizatori depoziton pranë AMLF-së, përpara hedhjes në qarkullim të biletës për kategorinë e lojës “Lotari me fitim në çast”, CD me kodet e sigurisë dhe çmimet fituese të biletave, si të prodhuara nga shtypshkronja, me të cilën organizatori ka lidhur kontratën. Kjo CD hapet vetëm në përfundim të lojës dhe në prani të organizatorit.

7. Për biletat të cilat nuk shtypen pranë SHLV-së, ndiqet kjo procedurë:

a) Vetëm shoqëritë e licencuara për organizim të lojërave të fatit, kanë të drejtën të lidhin kontrata për prodhim biletash të lojërave të fatit me shtypshkronjën prodhuese të biletave të tyre, të importojnë dhe të hedhin në treg bileta të lojërave të fatit;

b) Në rast se biletat janë shtypur jashtë vendit, në deklaratën e zhdoganimit duhet të jetë e përfshirë: sasia në copë e biletave dhe numri serial i tyre sipas çmimeve përkatëse. Një kopje e deklaratës së zhdoganimit i dërgohet AMLF-së nga dega doganore përkatëse dhe, gjithashtu, operatori i lojërave të fatit, përpara hedhjes në treg të biletave, i dërgon një kopje të deklaratës doganore, AMLF-së. Të gjitha procedurat e tjera janë të njëjta sikur biletat të ishin shtypur pranë SHLV-së.

c) Në rast se biletat shtypen në shtypshkronja brenda vendit, veprojnë të njëjtat dispozita si ato të shtypura pranë SHLV-së.



8. Organizatori i lotarisë së çastit/me shorte është i detyruar të publikojë në të gjitha pikat e shitjes së biletave:

a) Serinë e plotë të biletave të hedhura në qarkullim në të gjithë territorin e vendit;

b) Rregulloren e lojës.

9. Bileta *online* është e vlefshme kur regjistrohet në kohë reale në SQMO dhe merr një numër serial unik nga ky sistem.

10. Organizatorët e lojërave të fatit, duhet të deklarojnë çdo datë 20 të muajit (deklarim mujor):

a) Numrin e biletave të shitura;

b) Numrin e biletave fituese;

c) Numrin serial të biletave të shitura;

d) Vlera totale të biletave të shitura;

e) Vlera totale e biletave fituese.

10. Asgjësimi i biletave bëhet vetëm me miratim të drejtorit të Përgjithshëm të Lojërave të Fatit.

11. Udhëzimi i ministrit të Financave me nr. 8, datë 26.1.2009, “Për përcaktimin e skemës së duhur për shtypjen e biletave, shpërndarjen dhe kontrollin e hedhjes së tyre në përdorim”, shfuqizohet.

12. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 62, datë 13.5.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE
NË MODELIN E KONTRATËS SË
SHITBLERJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE NDËRMJET KESH SHA
(FPSH) DHE PRODHUESVE TË VEGJËL
TË ENERGJISË (PVE) MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 80, DATË 23.10.2009,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 11 dhe 14 të “Kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit transmetimi, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, nenit

26, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.5.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me disa ndryshime në modelin e kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 80 datë 23.10.2009, të ndryshuar,

konstatoi se:

- ERE ka detyrimin e përshtatjes së kuadrit ligjor ekzistues me parashikimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, janë miratuar rregullat mbi kushtet për vendosjen e detyrimeve të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike. Në kuptim të këtij vendimi në nenin 11 të këtyre rregullave është përcaktuar, se:

1. Çdo detyrim i vendosur ndaj të licencuarve në përputhje me legjislacionin në fuqi, në lidhje me burimet e rinovueshme të energjisë, do të konsiderohet detyrim i shërbimit publik.

2. Detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë i vendoset Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratës tip të miratuar nga ERE.

3. Në nenin 14 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 244, datë 30.3.2016, është vendosur:

- Këto rregulla do të shërbejnë si model i përkohshëm për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, deri në miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Enti Rregullator i Energjisë, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratojë aktet përkatëse për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këto kushte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe prodhuesve të vegjël të energjisë



elektrike miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 80, datë 23.10.2009, të ndryshuar, me përmbajtjen si më poshtë:

A1. Në titull, pjesën hyrëse dhe kudo në kontratë me palët do të referohen në cilësinë e shitësit, prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike dhe në cilësinë e blerësit operatori i shpërndarjes së Energjisë Elektrike - OSHEE sh.a.

A2. Paragrafi 5, në pjesën hyrëse ndryshon dhe bëhet:

- ERE me vendim të saj nr. _____, datë _____, ka licencuar shoqërinë _____ për prodhimin e Energjisë Elektrike; nga HEC-et _____, siç përcaktohet në licencën e dhënë nga ERE. OSHEE sh.a. duhet të nënshkruajë një kontratë për blerjen e energjisë elektrike me prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit transmetimi, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.

ERE ka autoritetin të përcaktojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike për prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike.

A3. Në nenin 1 “përkufizime” bëhen ndryshimet si më poshtë:

Termi “furnizues publik me shumicë” zëvendësohet me termin “OSHEE”, sipas përkufizimit në vijim OSHEE - është personi juridik i licencuar përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes të shtrirë në një zonë të caktuar dhe kur është e aplikueshme lidhjen e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficiencën e energjisë.

A4. Në pjesën përkufizime termi “prodhues i vogël i energjisë elektrike” zëvendësohet me termin “prodhuesit me përparësi”, sipas përkufizimit: “Prodhuesit me përparësi janë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të ligjit për energjitë e rinovueshme të energjisë elektrike”.

A5. Në pjesën përkufizime termi “ligj” ndryshon dhe bëhet “ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

A6. Në nenin 6.4 termi “vendi autorizuar” ndryshohet me termin “subjekt i autorizuar”.

A7. Në çdo rast përfaqësuesit e autorizuar të OSHEE sh.a., në bazë të Kodit të Matjes dhe me cilësinë e blerësit të energjisë, mund të kryejnë konform legjislacionit në fuqi inspektime dhe testime të sistemit të matjes dhe sistemet e tyre të regjistrimit. Punonjësi i impiantit përkatës do t'i vejë në dispozicion përfaqësuesve të OSHEE sh.a. regjistrin e leximit të matësit të energjisë elektrike dhe do t'i krijojë aksesin e nevojshëm për të kontrolluar sistemin e matjes.

A8. Në nenin 7 hiqet germa “b” e pikës 1 të këtij neni.

A9. Në nenin 8, në paragrafin e fundit, hiqen fjalët “të mbajtur me përfaqësuesit e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes”.

A10. Kjo Kontratë do të jetë në fuqi për një periudhë 15-vjeçare (pesëmbëdhjetëvjeçare). Për subjektet që kanë një kontratë të shitblerjes së energjisë elektrike me KESH sh.a., sipas vendimit nr. 80, datë 23.10.2009, në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate, kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike me OSHEE sh.a., do të lidhet për periudhën e mbetur nga përfundimi i kontratës së lidhur me KESH sh.a.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a. dhe të licencuarit në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 84 lekë